



BASHKIA
TIRANË

KESHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 87, datë 26.07.2017

PËR

“MIRATIMIN E DHËNIES SË AMBIENTIT NË PËRDORIM ORGANIZATËS SHOQËRORE TË PËRKRAHJES SË TË RINJVE - ARSIS, ME DESTINACION PËR QENDËR SOCIALE, NË ZBATIM TË PROJEKTIT “NGRITJA E SHËRBIMEVE PËR TË MBROJTUR FËMIJËT NGA ABUZIMI, NEGLIZHIMI, DHUNA DHE SHFRYTËZIMI NË TIRANË, NËPËRMJET VËNIES NË PUNË TË QENDRËS MULTIDISCIPLINARE NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR. 7”.

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1/1.1, shkronja (a) dhe pika 1/1.2, shkronja (a), nenit 24, pikat 1 dhe 3, nenit 54, shkronja (e) dhe nenit 55, pikat 4 dhe 6 të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”; nenit 901 dhe në vijim të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 350, datë 10.8.1992 të Këshillit të Ministrave “Për mënyrën e klasifikimit të ndërmarrjeve shtetërore në kombëtare ose lokale”; vendimit nr. 143, datë 18.01.2012 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës paraprake (pjesa e parë + pjesa e dytë) të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Tiranë, të Qarkut të Tiranës”; vendimit nr. 69, datë 20.12.2005 të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e listës së pjesshme të inventarit të pronave të paluajtshme të cilat janë në territorin nën juridiksionin e Bashkisë së Tiranës”; vendimit nr. 46, datë 28.07.2007 të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme shtetërore për të cilat Bashkia e Tiranës kërkon transferimin në pronësi të saj” dhe të vendimit të Këshillit Drejtues të Ndërmarrjes “Oficina e Automjeteve të Transportit Tiranë“, nr. 4, datë 28.06.2017, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, Këshillit Bashkiak:

V E N D O S I:

1. Të miratojë dhënien në përdorim pa kundërshtim për Organizatën Shoqërore të Përkrahjes së të Rinjve - ARSIS, për një afat 1-vjeçar, të ambientit me sipërfaqe truall Str =1280.0 m² (njëmijë e dyqind e tetëdhjetë) dhe sipërfaqe ndërtimi Snd. = 633.6 m² (gjashtëqind e tridhjetë e tre pikë gjashtë) të Ndërmarrjes Ofiçina e Automjeteve të Transportit (sipas Planimetrisë bashkëngjitur).
2. Pasuria, sipas pikës 1 të këtij vendimi, të përdoret për ofrimin e shërbimeve sociale nëpërmjet Qendrës Sociale “Shtëpia e Ngjyrave”.

3. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Liçencimit, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale dhe Ndërmarrja Ofiçina e Automjeteve të Transportit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit Nr.139/2015 për “Vetëqeverisjen vendore” dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë.

K R Y E T A R

ALDRIN DALIPI